VENDIM
Nr.769, datë 24.9.2010

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË BAJRAM CURRI, TË QARKUT TË KUKËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Bajram Curri, të qarkut të Kukësit, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Bajram Curri, të qarkut të Kukësit, miratuar me vendimin nr.12, datë 13.1.2006 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Bajram Curri, të qarkut të Kukësit".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Bajram Curri për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Bajram Curri Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
1	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative.	Në pronësi
14-19,21	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore (pasuria me nr.21 është në katin përdhe të një pallati pesëkatësh).	Në pronësi
38-51,53,54	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile.	Në pronësi
56,57	Prona që përdoren për shërbime sociale.	Në pronësi
58-67	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
68-69	Varreza publike	Në pronësi
81-82	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
22,23,84-91,92-95,100	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
99	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
104	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
125-128	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim

129,130	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive).	Në pronësi